



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna -Municipality
Hani i Elezit

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2, 40, Ligjin për Tregtinë e Brendshme Nr.2004/18, Ligjin Nr.04/-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 24, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15.1 shkronja (a), Kuvendi i Komunës me datën 30.09.2020 miratoi:

RREGULLORE
PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË TERRITORIN E
KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim ta përcaktojë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste, ditët në të cilat shitësi detyrohet të punojë dhe ditët kur nuk punohet për të gjitha subjektet të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Hanit të Elezit inspektimin e tyre dhe dispozitat ndëshkuese.

Neni 2
Fushëveprimi

Me këtë Rregullore përcaktohet orari i punës për të gjitha subjektet afariste të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, detyrat dhe obligimet e pronarëve dhe personave përgjegjës të subjekteve afariste.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. Orari i punës - periudha kohore e fillimit dhe mbarimit të punës.

1.2. Ditë pune - periudha kohore e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte.

1.3. Ditë vikendi - periudha kohore e fundjavës (dita e shtunë dhe e diel).

1.4. Festa zyrtare – ditët të cilat janë të përcaktuara si festa sipas Ligjit për festat zyrtare të Republikës së Kosovës.

1.5 Periudha verore – është periudhë sezonale që fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator të vitit kalendarik;

1.6. Periudha dimërore – është periudhë sezonale, që fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars të vitit kalendarik.

II. ORARI I PUNËS

Neni 4

Përmbajtja e orarit të punës

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore të fillimit dhe mbarimit të punës.
2. Periudha kohore e fillimit dhe mbarimit të punës caktohet për ditë të rregullta të punës, ditë të punës gjatë vikendeve dhe ditë të punës gjatë festave zyrtare.
3. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar sipas kësaj rregulloreje, duhet të vendoset në hyrje të objektit apo në pjesë të dukshme ku ushtrohet veprimtari afariste, duke e saktësuar fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, si dhe ditët kur nuk mund të punohet.
4. Orari i punës përcaktohet në bazë të dy periudhave, në atë verore dhe dimërore, në interval kohor:
 - 4.1. periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator të vitit kalendarik;
 - 4.2. periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars të vitit kalendarik.

Neni 5

Respektimi i orarit të punës

1. Të gjitha subjekteve afariste të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Hanit të Elezit janë të obliguara ti përmbahen orarit të punës siç është përcaktuar me këtë rregullore.
2. Të gjitha subjektet afariste janë të obliguara që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ekonomike të mos ndikojnë negativisht në prishjen e qetësisë së banorëve përreth.
3. Të gjitha subjektet afariste janë të obliguara që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ekonomike të mos bien ndesh me Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike dhe Ligjin për Mbrojtje nga Zhurma, si dhe aktet tjera nën ligjore që rregullojnë këtë fushë.
4. Të gjitha subjektet afariste mund të shkurtojnë orarin e përcaktuar të punës të paraparë me këtë rregullore. Për punën me të shkurtër, për ditët kur nuk punohet, përveç njoftimit që duhet të vendoset në hyrje të lokalit afarist, paraqitet kërkesë sipas nenit 26 të kësaj rregullore.

Neni 6

Vendosja e orarit të punës

Të gjithë pronarët dhe personat përgjegjës të subjekteve afariste janë të obliguar që në hyrje të lokalit afarist në vend të dukshëm të vendosin orarin e punës siç është paraparë në këtë rregullore, duke përfshirë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, ditët kur nuk punohet dhe kohën e pauzës në rastet kur praktikohet.

Neni 7
Orari i punës në veprimtari zejtare

1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të veprimtarive zejtare:
 - 1.1 Periudha verore prej orës 07:00 deri në orën 20:00
 - 1.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 deri në orën 18:00
 - 1.3 Të dielave nuk punojnë
2. Gjellëtoret dhe qebaptoret punojnë çdo ditë pune
 - 2.1 Periudha verore fillon prej orës 06:00 -23:00
 - 2.2 Periudha dimërore prej orës 06:00 -21:00
 - 2.3 Kurse ditën e premte dhe të shtunën prej orës 06:00-02:00 pas mesnate.
3. Ditët e fundjavës përkatësisht të dielën dyqanet zejtare nuk do të punojnë përveç : furrat e bukës, gjellëtoret, qebaptoret, sallonet e ondulimit, rrobaqepësit/et, floktarët dhe autolarjet.

Neni 8
Orari i punës për veprimtaritë e zyreve të punës

Orari i punës për avokat, përmbauesit privat, sportele të pagesave, zyra juridike dhe ekonomike, zyra të përkthyesve, zyra gjeodezike, këmbimore dhe tjera të ngjashme, gjatë ditëve të javës është prej orës 08:00 deri në orën 17:00 dhe i njëjti orar vlen edhe për ditën e shtunë ndërsa dita e diele është ditë pushimi.

Neni 9
Orari i punës në qendra tregtare, vetëshërbime, supermarkete dhe dyqane ushqimore dhe joushqimore, depot e ndryshme

1. Orari i punës në vetëshërbime, supermarkete dhe dyqane ushqimore, do të jetë:
 - 1.1 Periudha verore prej 07:00-23:00 .
 - 1.2 Periudha dimërore prej orës 08:00-22:00.

Neni 10
Orari i punës në dyqanet tregtare të tekstilit, dyqanet e këpucëve, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake “teknikës së bardhë ”

1. Orari i punës në këto dyqane do të jetë :
 - 1.1 Periudha verore prej orës 07:00-21:00
 - 1.2 Periudha dimërore prej orës 08:00-20:00

Neni 11
Orari i punës së barnatoreve farmaceutike

1. Orari i Barnatoreve do të jetë i njëjtë në dy sezonat, fillon në ora 08:00 dhe mbaron në ora 22:00.
2. Barnatoret që veprojnë në komunën e Hanit të Elezit , në harmoni me planin për gatishmëri, të hartuar në bashkëveprim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik do të jenë në gatishmëri 24 orë (pa ndërprerë), sipas renditjes - rotacionit të hartuar nga drejtoritë kompetente.
3. Barnatoret ditën e diel dhe ditët e festave zyrtare do të kujdestarojë vetëm një barnatore nga ora 08:00 - 22:00 dhe të vazhdohet me gatishmëri sipas renditjes-rotacionit të hartuar nga drejtoritë kompetente.

Neni 12
Orari i punës së ordinancave private mjekësore

1. Orari Ordinançave private mjekësore do të jetë i njëjtë në dy sezonat, fillon në ora 08:00 dhe mbaron në ora 22:00.

Neni 13
Orari i punës së barnatoreve bujqësore

1. Barnatoret bujqësore do të punojnë prej orës 08:00 deri në 19:00.
2. Barnatoret bujqësore përjashtimisht mund të punojnë jashtë këtij orari në sezonën e mbjelljeve, korreshirjeve si dhe ditëve të vikendit; me pëlqim paraprak të lëshuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, sipas nenit 26 të kësaj rregullore.

Neni 14
Orari i punës në depot e artikujve ushqimorë, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit

1. Periudha verore prej orës 07:00-19:00
2. Periudha dimërore prej orës 07:00-18:00

Neni 15
Orari i punës në miniera dhe gurore (industria nxjerrëse)

1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të xeheroret dhe guroret tjera (industria nxjerrëse) do të jetë si vijon:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 07:00 deri në orën 19:00;
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 07:00 deri në orën 17:00.
 - 1.3. Objekti i Thërrmueses për dy periudhat (verore-dimërore) është i njëjtë 07:00-23:00.
 - 1.4 Gurthyesit ditën e diel nuk punojnë, por i lejohet vetëm transporti.

Neni 16
Orari punës te Industritë përpunuese

1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te përpunimi i produkteve ushqimore, në periudhën verore fillon prej orës 07:00 deri në orën 23:00 ndërsa për periudhën dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 22:00.
2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te prodhimi i pijeve në periudhën verore fillon prej orës 07:00 deri në orën 23:00 ndërsa për periudhën dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 23:00.
3. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te prodhimi i tekstilit, veshjeve, prodhimi i lëkurës dhe produkteve të lëkurës do të jetë i njëjtë në dy sezonet dhe fillon prej orës 07:00 deri në orën 23:00.
4. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit, të tapës, përveç mobileve; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara, prodhimin të miellit, thurëse, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës dhe shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara, prodhimi i produkteve kimike, prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike, prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës, prodhimi i produkteve minerale jo materiale, prodhimi i metaleve, prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike, automekaniket dhe ngjyrosësit e automjeteve, prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektrike dhe optike, prodhimi i pajisjeve elektrike, prodhimi i makinerisë, prodhimi i makinerive motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove, prodhimi i mobileve, riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve do të jetë i njëjtë në dy sezonet dhe fillon prej orës 07:00 deri në orën 23:00.

Neni 17
Orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore

1. Orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë), do të jetë:??
 - 1.1 Periudha verore prej orës 08:00-18:00
 - 1.2 Periudha dimërore prej orës 08:00-16:00.
 - 1.3 Ditën e fundjavës (të dielën) nuk punojnë.
2. Ndërmarrjet ndërtimore në rastet të jashtëzakonshme për shkak të natyrës së punës mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 22:00, duke paraqitur kërkesë sipas nenit 26 të kësaj rregullore.

Neni 18
Orari i punës i ndërmarrjeve për furnizimi me ujë, kanalizim, veprimtaritë e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave

1. Orari i punës te veprimtaritë: furnizim me ujë, kanalizim, veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve, trajtimi i mbeturinave dhe asgjësimi i tyre do të jetë i njëjtë në dy sezonet, 24:00 (pa ndërprerë).
2. Gjatë ditëve të vikendit (të shtunave dhe të dielave) dhe festave zyrtare subjektet afariste të cekura në paragrafin 1 të këtij neni do të punojnë me orar të njëjtë.

Neni 19
Orari i punës për Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike

Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë e arkitekturës dhe inxhinierisë; analizat dhe testimet teknike, fillon në orën 08:00 dhe mbaron në orën 20:00 në të dy sezonet ndërsa gjatë ditëve të vikendit subjektet afariste (të dielën) nuk do të punojnë.

Neni 20
Orari i punës së kafeneve

1. Orari i punës së kafeneve do të jetë:
 - 1.1 Periudha verore prej orës 07:00-24:00
 - 1.2 Periudha dimërore prej orës 08:00-24:00

Neni 21
Orari i punës në hotele, motele dhe restorante, sallat e dasmave?

1. Orari i punës në hotele, motele, restorante dhe sallat e dasmave në të dy sezonet fillon prej orës 07:00-24:00 përjashtimisht deri në ora 02:00 (të mëngjesit) sipas nenit 26 të kësaj rregullore.
2. Hotelet dhe motelet mund të punojnë pandërprerë vetëm me shërbime të fjetjes, mirëpo duke kufizuar të gjitha shërbimet tjera (restorant, bar, etj) pas orarit te caktuar nga 07:00-24:00.
3. Motelet, Hotelet, Restorantet, qebaporet , marketet dhe subjektet e tjera afariste të cilat operojnë rreth magjistrales mund të punojnë pandërprerë (24:00) orë.

Neni 22

Orari i punës në kafe –bare, diskoklube, internet kafe

1. Orari i punës në kafe-bare dhe diskoklube është i njëjtë për të dy sezonat , fillon në ora 20:00 dhe mbaron në orën 02:00 (të mëngjesit).
2. Orari i punës në klubet e natës është i njëjtë në të dy sezonet, fillon prej orës 22:00 dhe mbaron në orën 03:00 (të mëngjesit)
3. Orari i punës për internet –kafe fillon në orën 08:00 dhe mbaron në orën 24:00 në të dy sezonat.

Neni 23

Orari i punës në pikat e shitjes së derivative të naftës

- 1.Orari i punës në pikat e shitjes së derivateve të naftës është i pakufizuar ashtu që të njëjtat subjekte afariste mund të punojnë pandërprerë në të dy periudhat e llogaritjes së kohës sipas sezonave.
2. Restorantet, kafiteritë, shitoret ushqimore që janë nën menaxhimin e pikave të shitjes së karburanteve , mund të punojnë pa ndërprerë.

Neni 24

Orari në stadiume dhe pishina

- 1.Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe palestrat sportive, pishina të hapura punojnë prej orës 08:00-24:00 pas mesnate.

Neni 25

Ruajtja e rendit dhe qetësisë publike

Të gjitha subjektet afariste duhet të jenë të kujdesshme gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre përkatësisht nuk iu lejohe t'u prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Siguri Publike dhe Ligjit për Mbrojtje nga Zhurma.

Neni 26

Zgjatja e orarit të punës

Subjektet të cilët kërkojnë leje për vazhdimin e orarit të punës jashtë afatit të caktuar me këtë rregullore, duhet t'i drejtohen me kërkesë organit kompetent, përkatësisht Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik minimum tri ditë para ushtrimit të asaj veprimtarie.

Neni 27

Orari i punës për tregje

1. Tregjet e qytetit do të punojnë vetëm ditën e mërkurë dhe sipas orarit në vijim:

1.1. Periudha verore – prej orës 07:00-20:00

1.2. Periudha dimërore – prej orës 08:00-19:00

Neni 28

Zgjatja e orarit të punës të subjekteve afariste

- 1.Subjektet afariste mund të zgjasin orarin e punës me rastin e festave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për festat zyrtare deri në ora 02:00 të mëngjesit, konform nenit 26 të kësaj rregullore.
2. Subjektet afariste janë të obliguara që me rastin e festave zyrtare të vendosin flamujt shtetëror.

III.DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 29

Inspektimi i respektimit të orarit të punës të subjekteve afariste

1. Inspektori i tregut në bazë të kërkesës së qytetarëve dhe detyrës zyrtare, mund të inspektojë shoqëritë tregtare lidhur me respektimin e orarit të punës sipas kësaj rregulloreje.
2. Gjatë inspektimit të shoqërive tregtare, inspektori duhet të inspektojë se a është vendosur njoftimi – publikimi i orarit të punës dhe ditëve kur nuk punohet, në vendin e dukshëm në hyrje të objektit afarist ku shihet dhe se a është zgjatur apo shkurtuar orari i punës sipas kësaj rregulloreje.
3. Nëse shoqëritë tregtare nuk u përmbahen dispozitave të kësaj rregulloreje, inspektori gjatë inspektimit do të shqiptoj gjoba sipas Ligjit për Kundërvajtje.

IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 30

Mbikëqyrja

1. Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdesen: Drejtoria për Zhvillimi Ekonomik, Inspektori i Tregut dhe Policia e Kosovës.
2. Gjatë kryerjes së inspektimit, inspektorati komunal dhe të tjerët që janë të autorizuar që në përputhje me ligjin të veprojnë në përputhshmëri të kësaj rregullore.

Neni 31

Shfuqizimi

Me hyrjen e kësaj Rregulloreje në fuqi, shfuqizohet Vendimi për Përcaktimin e Orarit të Punës për Subjektet Afariste që funksionojnë në territorin e Komunës së Hanit të Elezit 01nr.31/09.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Rregullorja hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.09. 2020

